


VEPËR E VEÇANTË PËR AHMET EF. KORONICËN

(Alban Dobruna, *Ahmet Koronica në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*,

Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020, f. 268)



*“Qi po i kisht’,
po, nja tri
zêmra, E po e
kisht’ sÿnin rrfë:
Qi s’ la Pashë
me thye kanunin,
Qi s’ la beg me
fikë katundin, nuk
la agë me bâ
plaçkë grunin.*

Vall, ç’ ká thânë hoxhë Korenica”.
(Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, S. Maria, Angli, 1991, f. 175).

Vargjet e lartcekura janë vlerësim që i bëhet Ahmet ef. Koronicës nga poeti ynë i njohur Gjergj Fishta, ku përshkruhet, si njeri me tri zemra, me syrin si rrëfe, njeri i kanunit, i drejtësisë e dalzotës i atdheut.

Për këtë personalitet historik ka pasur disa përpjekje shkrimore për ta ndriçuar veprimtarinë e tij. Shkrimet e derisotme për Ahmet ef. Koronicën, përgjithësisht, mund të thuhet se kanë pasur karakter publicistik, përjashtojë shkrimin e studiuesit Masar Rizvanolli. Mirëpo, deri më sot, nuk kemi një ndërmarrje kaq përmbledhëse, çfarë na ka ofruar pu-

nonjësi shkencor i Instituti të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, dr. Alban Dobruna.

Libri i radhës i dr. Alban Dobrunës, me titullin “*Ahmet Koronica në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*” është përpjekje studimore për njërin ndër themeluesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kadiun e Gjakovës e Manastirit, anëtarin e Komitetit të Stambollit, themeluesin e Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Gjakovë, njërin ndër organizatorët e vrasjes së gjeneralit osman në Gjakovë.

Duke shfletuar materiale për jetën dhe veprën e Ahmet ef. Koronicës, studiuesi Alban Dobruna, vjen në konkludim se për këtë personalitet ka materiale të mjaftueshme për ta finalizuar një libër rreth veprimtarisë së tij në Lëvizjen Kombëtare, posaçërisht gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këtë synim autori i kësaj vepre e ka arritur. Dr. Alban Dobruna ka tubuar materiale solide për këtë personalitet dhe i ka sistemuar brenda një metodologjie të caktuar, duke na ofruar një kontribut shkrimor të vyer, që i ka munguar

lexuesit dhe të tjerëve të interesuar në një format të tillë.

Ahmet ef. Koronica, siç ofron të dhëna edhe autori i librit dr. Alban Dobruna, vinte nga radhët e krerëve fetarë myslimanë të Gjakovës. Ishte nga prijësit fetarë që binomin fe – atdhe, në periudha të caktuara, e kuptoi si diçka të rëndësishme në jetën e shqiptarëve. Ishte nga ato personalitete, që edhe pse i përkiste radhëve të krerëve fetarë, në rastet vendimtare për fatin e vendit të tij, aspektin kombëtar e pa me përparësi. Ky aspekt i jetës së tij, shpërfaqet sidomos në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ahmet ef. Koronica, pranon rolin e kryetarit të degës së Lidhjes Shqiptare të Gjakovës, por me vonë, me fraksionet që lindin brenda organizatës së Lidhjes Shqiptare, Ahmet ef. Koronica radhitet në anën e krahut nacionalist të kësaj organizate, mes atyre që mendonin se hapësirat shqiptare që kishin mbetur nën Malin e Zi dhe Serbinë, si rezultat i politikave botërore, të mbroheshin deri në pikën e fundit, duke mos u pajtuar që këto toka të jepeshin pa rezistencë. Këtë bindje të tij se tokat shqiptare, të dhuruara nga Konferenca e Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit, nuk duhet t’u jepeshin fqinjëve, Ahmet ef. Koronica e shpërfaqti edhe me rastin e ardhjes së mareshalit osman në Gjakovë, Maxhar Pashës, i cili kishte ardhur t’i bindte krerët e Lidhjes së Prizrenit, posaçërisht ata të Gjakovës, se tokat shqiptare u ta-

konin fqinjëve. Popullata e Gjakovës me rrethinë, në mesin e të cilëve edhe Ahmet ef. Koronica me bashkëmendimtarët dhe veprimtarët e tij, arritën ta vrasin Maxhar Pashën në konakun e Abdullah Pashë Drenit. Kjo vrasje bëri jehonë në vend dhe në aspektin ndërkombëtar. Pikërisht, këto ngjarje, duke u mbështetur në literaturë dhe burime relevante, dr. Alban Dobruna ka bërë përpjekje, t’i argumentojë. Kështu, veprimet e Ahmet ef. Koronicës dhe bashkëveprimtarëve të tij ndaj mareshalit osman i cilëson si të drejta, duke ofruar edhe analizë të ngjarjeve.

Libri përveç përmbajtjes, parathënies, përfundimit, burimeve dhe literaturës, përbëhet edhe nga katër kapituj:

Në *kapitullin e parë* ofrohen të dhëna për konferencën e njohur të Shën Stefanit në raport me shqiptarët. E quaj konferencë, sepse për mua është gabimisht të përdorej termi *paqe* në raport për shqiptarët, ngase një konferencë të tillë për shqiptarët prodhoi mjaft padrejtësi e gjakderdhje. Më pastaj, trajtohen Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Sepse, ishin pikërisht këto ngjarje, që u zhvilluan dhe si rezultat nxorën në pah edhe personalitetin e Ahmet ef. Koronicës.

Në *kapitullin e dytë* autori ofron të dhëna për origjinën e Ahmet ef. Koronicës, i cili vinte nga një familje fisnike dhe pronare çifligjesh, përmend shkollimin e tij në Stamboll për shkenca islame, kontributin e tij

në Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, ku bënin pjesë elita intelektuale shqiptare e kohës si: vëllezërit Frashëri, Hasan Tahsini etj. Pjesë e këtij komiteti ishte edhe Ahmet ef. Koronica nga ku kishte marrë edhe disa instruksione për format e veprimtimit në mbrojtje të drejtave shqiptare në vendin ku do të vepronte. Në këtë kapitull trajtohet edhe gjendja në Gjakovë para formimit të Lidhjes Shqiptare.

Kapitulli e tretë është edhe pjesa qendrore e librit. Këtu shpërfaqet roli i Ahmet ef. Koronicës në formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe si udhëheqës i Degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë dhe roli i tij në revoltën e një pjesë të popullit ndaj Mehmet Ali Pashë Maxharrit. Në të gjitha këto organizime, pa dyshim Ahmet ef. Koronica, siç vë në dukje edhe autori i këtij libri, ishte shtylla kryesore.

Në *Kapitullin e katërt* autori vë në trajtim jehonën e vrasjes së Mehmet Ali Pashë Maxharrit në arenën ndërkombëtare dhe ndikim që kjo vrasje pati në trevat shqiptare. Trajtohet kontributi i Ahmet ef. Koronicës në Lëvizjen e Lidhjes Shqiptare për autonomi dhe roli i tij në formimin e Lidhjes së Re Shqiptare të Prizrenit në Gjakovë.

Si përfundim, mund të thuhet se historiani e studiuesi, dr. Alban Dobruna ka bërë përpjekje maksimale për ta realizuar një vepër të veçantë historike, për një personalitet të rë-

ndësishëm të lëvizjes sonë kombëtare, siç është Ahmet ef. Koronica.

Duke e pasur parasysh veprimtarinë e bujshme jetësore të Ahmet ef. Koronicës, në të ardhem ndoshta do të shkruhet edhe nga të tjerët për veprimtarinë e këtij personaliteti, por deri në këtë stad, ky material i sistemuar dhe analizuar nga studiuesi dr. Alban Dobruna mban epitetin e studimit më serioz të shkruar deri sot për personalitetin e Ahmet ef. Koronicës. Përkitazi me këtë mendim, do ta citoj veprimtarin e njohur Hafiz Ali Ulqinaku, i cili thoshte: “*Kush mundet ma mirë e ka rrugën e lirë*”.

Libri do t’iu shërbejë studiuesve, studentëve dhe të gjithë atyre që janë të interesuar të dinë për jetën dhe veprën e këtij personaliteti.

Dhe në fund themi se, përveç vargjeve të poetit tonë kombëtar Gjergj Fishta për personalitetin e Ahmet ef. Koronicës, të përfshira në veprën monumentale “Lahuta e Malcisë”, shkrimeve të shkurtra biografike të botuar për këtë personalitet në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (ASHSH, Tiranë, 1985, f. 532-533) dhe në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës (vëll. 1, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 856), shkrimeve të profesor Masar Rizvanollit e poetit Kadrush Radogoshit, bibliotekave tona u shtohet edhe kontributi studimor i autorit dr. Alban Dobruna.

Nuridin AHMETI

